

Datë 19.12.2022

RREGULLORE E BRENDSHME

PER PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT

Neni 1

Kjo rregullore nxirret në mbështetje dhe për zbatim të:

- Ligjit Nr. 9917, dt 19.05.2008, “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 157/2013, dt 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 72/2019, dt 17.10.2019, “Për Masat Shtrënguese Ndërkombëtare Në Republikën e Shqipërisë”.
- Udhëzimi nr. 28, dt 31.12.2012 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “ *Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit*”, i ndryshuar
- Udhëzimi nr. 29, dt 31.12.2012 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “*Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jo financiare*”, i ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të brendshme për identifikimin e klientëve, regjistrimin e tyre, raportimin e të dhënave dhe procedurat e tjera që duhen ndjekur për zbatimin e plotë të kuadrit ligjor të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Subjekti përcakton një person përgjegjës për çështjet e PP/FT si dhe çdo punonjës pranë subjektit është i detyruar të njihet me përmbajtjen e ligjit “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”.

Neni 3

Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim me përkufizimet e përdorura në ligjin Nr. 9917, dt 19.05.2008, “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 28 dt 31.12.2012 i Ministrisë të Financave dhe

Ekonomisë “ *Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit*”, i ndryshuar si dhe Udhëzimin 29 dt 31.12.2012 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “ *Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jo financiare*”, i ndryshuar.

Neni 4

Njohja, identifikimi dhe pranimi i klientëve

(Procedura njih klientin tënd)

Subjekti para se të pranojë të kryejë shërbimet për një klient, duhet të zbatojë të gjitha procedurat e njohjes, identifikimit të tyre me anë të dokumenteve të identifikimit në mënyrë të plotë dhe të saktë nëpërmjet ID, pasaportës biometrike, certifikatës familjare. Të dhënat identifikuese të klientit duhet të ruhen në dosje të veçanta të bashkëngjitura me aktin përkatës.

Subjekti nuk duhet të krijojë marrëdhënie biznesi me persona anonimë apo fiktivë, marrëdhënie biznesi me shoqëritë dhe personat e listuar në listat e Terroristëve publikuar periodikisht nga DPPP.

Ligji ka prezantuar një sistem procedure “Njih klientin tënd”:

- Procedura e Vigjilencës së Duhur.
- Procedura e Vigjilencës së Zgjeruar.

Këto procedura janë përshkruar më hollësisht në këtë rregullore.

Neni 5

Vigjilenca e Duhur

Procedurat “Njih Klientin tënd” janë një nga etapat e vigjilencës së duhur ndaj klientit.

- Identifikimi Klientit nëpërmjet dokumenteve personale të tij.
- Identifikimi pronarit përfitues (personit fizik) dhe verifikimi i këtij identifikimi, në mënyrë që subjekti të krijojë bindjen se kush është pronari përfitues përfundimtar.
- Identifikimi klientëve bëhet me anë të burimeve të pavarura dhe të besueshme nëpërmjet dokumenteve origjinale, që janë:

Për individët:

- Letërnjoftim ID
- Pasaportë brenda afatit të vlefshmërisë

Për shoqëritë:

- Ekstrakt historik, i lëshuar nga QKB, në datën e kryerjes së veprimit pranë subjektit
- Karta ID e administratorit të shoqërisë.

- Dokumente të tjera shtesë, që mund të kërkohen nga subjekti sipas nevojës për identifikim, dhe verifikim të identitetit të klientit janë:
- Certifikatë, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile.

Neni 6

Vigjilenca e Zgjeruar

Me qëllim zbatimin e Vigjilencës së Zgjeruar, subjekti duhet të kërkojë praninë fizike të klientit. Kategoritë e transaksioneve për të cilat kërkohet Vigjilenca e Zgjeruar:

1. Personat e ekspozuar politikisht. (PEP)
Nëse një klient është apo bëhet i ekspozuar politikisht para ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit, punonjësit e shoqërisë duhet të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme si lista e përditësuar e PEP, vendas, lista e përditësuar nga autoritetet përgjegjëse nga IDP, ASHK, etj ;
2. Për klientët, të cilët janë organizata jofitimprurëse;
3. Klientët jo rezidentë, veçanërisht kur këto transaksione kryhen pa praninë fizike të klientit;
4. kategoritë e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende për të cilat kërkohet marrja e masave të posaçme, sipas përcaktimeve apo kërkesave të autoritetit përgjegjës;
5. Klientë organizime ligjore apo shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit, transaksioneve të kryera në emër apo për llogari të tyre, si dhe kur organizimet ligjore apo shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit janë pjesë e strukturës së pronësisë, kontrollit apo vendimmarrjes së klientëve të tyre;
6. Për të gjitha transaksionet me vlera të larta dhe për të gjitha llojet e transaksioneve të pazakonta, që nuk kanë një qëllim të qartë ekonomik ose juridik;

Në rastet kur subjekti nuk ka mundësi të zbatojë detyrimin e Vigjilencës së Zgjeruar si pasoje e mosvënies në dispozicion nga ana e klientit për arsye të tjera:

- Nuk duhet të fillojë një marrëdhënie biznesi me klientin.
- Nëse i ka filluar, t'i ndërpresë ato.
- Duhet të dërgojë raport si aktivitet i dyshimte tek autoritetet përgjegjëse.

Neni 7

Grumbullimi dhe regjistrimi i të dhënave

Për çdo klient me të cilin vendoset marrëdhënie biznesi duhet të regjistrohen të dhënat sipas gurmës “c” të pikës 1 të nenit 11 të ligjit të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Personi përgjegjës duhet të mundësojë grumbullimin, regjistrimin dhe analizimin e të dhënave në një sistem i cili duhet të përmbajë së paku të dhënat sipas tabelës si vijon:

Emër
Atësi
Mbiemër
Datëlindje
Vendlindje
Nr. Identifikimi
Lloji i dokumentit
Emri i shoqërisë
NIPT
Adresa
Shuma e transaksionit
Monedha
Lloji i transaksionit
Data e transaksionit
Mënyra e kryerjes së transaksionit
Burimi i deklaruar i fondeve
Arsyeja e kryerjes
Persona të tjerë të përfshirë

Tabela nr. 1-Të dhënat e sistemit të centralizuar

Të dhënat duhet të ruhen në format shkresor si dhe të pasqyrohen në format elektronik të përpunueshëm (Excel).

Neni 8 Monitorimi i vazhdueshëm

Subjekti duhet të kryejë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin. Ky monitorim bëhet për t'u siguruar nëse transaksionet janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për klientin, si dhe burimin e fondeve. Ky proces kërkohet të ndërmerret veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me rrezik të lartë dhe duhet të zbatohet menjëherë kur ka arsye për të dyshuar se situata faktike e klientit ka ndryshuar.

Neni 9 Masat kundër financimit të terrorizmit

Masat e marra kundër Financimit të Terrorizmit në përputhje me Ligjin Nr. 157/2013, datë 10.10.2013 "Për Masat Kundër Financimit të Terrorizmit", i ndryshuar.

Lidhur me masat kundër Financimit të Terrorizmit në përputhje me ligjin Nr. 157/2013, datë 10.10.2013 "Për Masat Kundër Financimit të Terrorizmit", i ndryshuar, subjekti duhet të konsultohet me listat e përditësuara të personave të shpallur si financues të terrorizmit në faqen zyrtare të DPPPP, duke kryqëzuar të dhënat e klientëve me këto lista. Gjithashtu subjekti duhet të njihet me udhëzuesin mbi sanksionet ndërkombëtare dhe të përditësohet me "Listën e personave të shpallur".

Neni 10

Struktura e brendshme

Për parandalimin dhe luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, subjekti ka për detyrë;

- Të kontrollojë transaksionet në apo mbi 1 milion lek në para fizike, apo të barazvlefshmen e tyre në monedhë të huaj.
- Transaksionet e dyshimta.
- Të caktojë një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave

Neni 11

Afati për ruajtjen e dokumentacionit

Subjekti për qëllimin e kryerjes së transaksioneve duhet të mbajë të ruajë të gjithë dokumentacionin për një periudhë të paktën 5 vjeçare dhe jo më shumë se 40 vjet, të cilat duhet t'i vihen në dispozicion të autoriteti përgjegjës, që është DPPPP mbi bazë të një kërkesë të këtij të fundit, jo më vonë se 15 ditë kalendarike.

Të dhënat e detyrueshme mbi transaksionet e kryera dhe klientët ruhen në mënyrë të saktë dhe kronologjike pa korrigjime që të mundësojë kontrollin nga DPPPP.

Subjekti duhet të ruajë dokumentacionin për identifikimin, llogaritë si dhe kontratat me klientin për 5 vjet nga data e mbylljes së llogarisë apo përfundimit të marrëdhënies të biznesit.

Neni 12

Raportimi i Aktiviteteve Të Dyshimta tek Autoriteti Përgjegjës

Personi Përgjegjës duhet të paraqesë një informacion pranë Autoritetit Përgjegjës në rastet kur dyshon se po kryhet apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financim

terrorizmi ose fonde që burojnë nga veprimtari kriminale menjëherë. Raportimi duhet të kryhet me anë të formularit RAD menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

Ky raportim kryhet pas shqyrtimit të plotë të elementëve të dyshimtë dhe të dhënave që subjektet kanë në dispozicion për të analizuar dhe arsyetuar, pavarësisht shumës së transaksionit/transaksioneve të kryera, që janë duke u kryer ose do të kryhen.

Përveç raportimit pranë Autoritetit Përgjegjës, gjithashtu subjekti mund të kërkojë udhëzime nëse duhet të kryejë ose jo transaksionin dhe brenda një afati prej 48 orësh nga marrja dijani.

Autoriteti Përgjegjës përgjigjet duke lejuar kryerjen e transaksionit ose nxjerrjen e urdhër bllokimit në varësi të rastit. Në rastet kur Autoriteti Përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti vazhdon me kryerjen e transaksionit.

Formulari RAD duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm që mbështet dyshimet e parashtruara në raport si: nxjerrjen e llogarive bankare, dokumentacioni i identifikimit, të dhënat e transfertave, kontrata noteriale, etj.

Punonjësve të subjektit iu ndalohe të informojnë klientin apo çdo person tjetër në lidhje me këtë informacion.

Neni 13

Raportimi i transaksioneve të parasë fizike

Personi Përgjegjës në përputhje me nenin 12 pika 3 e Ligjit¹ është i detyruar të raportojë tek Autoriteti Përgjegjës brenda ditës pasardhëse të punës nga data e kryerjes, të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose me të madhe se 1.000.000 (një milion) lek ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, kryer si një transaksion i vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve.

- Në funksion të zbatimit të këtij neni, çdo transaksion i cili nuk është i shoqëruar me një dokumentacion justifikues bankar, do të konsiderohet i kryer në para fizike.

Neni 14

Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë

Procedurën e vendosjes, zbatimit, ndryshimit dhe shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë i vendos, zbaton, ndryshon ose shfuqizon në përputhje me Kushtetutën, të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB;

¹ Ligji Nr. 9917, dt 19.05.2008, "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit", i ndryshuar.

Subjektet, ndaj të cilave vendosen masat shtrënguese ndërkombëtare, sipas këtij ligji, janë :

- a) shtetet;
- b) personat fizikë;
- c) personat juridike;
- c) organizimet ligjore;
- d) entitete të tjera;

Neni 15

Masat kundër financimit të terrorizmit

Në bazë të nenit 10 “Detyrimi për raportim” të ligjit 157/2013, ekzistojnë dy detyrime për raportim:

- për subjektet e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të cilët duhet të raportojnë pranë DPPPP informacione ose dyshime për veprime financiare, transaksione, fonde ose akte të tjera të kryera ose që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen ose financimin e akteve terroriste pavarësisht nga vlera e tyre.
- Për çdo person që ka dijeni për veprimet financiare, transaksionet, fondet ose aktet e tjera të kryera ose që janë përpjekur të kryhen, me qëllim kryerjen ose financimin e akteve terroriste, për të cilët kanë detyrim për të njoftuar menjëherë DPPPP.

Në çdo rast, raportimi duhet të kryhet menjëherë dhe pa përfshirje të personave të dyshuar ose të tretëve si dhe duhet të përmbajë të dhëna për identifikimin e fondeve e pasurive të tjera, të dhëna në lidhje me pronësinë dhe interesa të lidhura si dhe shpjegime për motivet që mbështesin të dhënat.

Duhet të raportohen dhe transaksionet në tentativë, në rastet kur: subjekti ka refuzuar të vendosë marrëdhënie biznesi, klienti vendosë të mos realizojë transaksionin ose për arsye të tjera.

Neni 16

Auditimi i brendshëm

Subjekti duhet të ngarkojnë kontrollin e brendshëm për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet e zbatimit të kuadrit rregullativ dhe procedurave dhe të përpilojë raportet përkatëse bazuar në standartet e Auditimit të Brendshëm. Këto raporte janë objekt kontrolli gjatë inspektimeve nga DPPPP, apo organe të tjera të ngarkuara me ligj.

Neni 17

Vlerësimi i riskut

Subjekteve të ligjit iu kërkohet të zbatojnë masat në fushën e PP/FT në sajë të qasjes me bazë risku e cila nënkupton procesin ku bëhet i mundur identifikimi i rreziqeve të mundshme për PP/FT si dhe zhvillimi i strategjive për t'i administruar ato në mënyrë efektive.

Për të mundësuar një vlerësim risku sa më të plotë e gjithëpërfshirës duhet të merret në konsideratë një vlerësim kombëtar të riskut si dhe vlerësime sektoriale të kryera në përputhje me aktivitetin e kryer nga vetë subjekti.

Klasifikimi i riskut vlerësohen sipas kategorive të mëposhtme:

- Klienti;
- produkti, shërbimi, transaksioni, praktikat e biznesit dhe mënyra e ofrimit;
- gjeografia;

Neni 18 **Tregues të anomalive**

Bashkëlidhur kësaj rregullore (Aneksi 1) janë paraqitur një numër treguesish të cilët janë orientues, jo shterues ose përjashtues, por i shërbejnë subjektit për të identifikuar anomali që lidhen me PP/FT.

Aneksi 1 është pjesë tërësore e kësaj rregulloreje dhe i nënshtrohet ndryshimeve në mënyrë periodike.

Personi Përgjegjës

XXX

ANEKSI 1

Tregues të anomalive

- Klienti synon të formojë/blejë një kompani, objekti i aktivitetit të së cilës është i paqartë dhe në dukje nuk ka lidhje me aktivitetin e tij aktual;
- Klienti është i përfshirë në transaksione të cilat në dukje nuk lidhen ose janë jashtë profilit të tij
- Mallra ose pasuri të paluajshme të cilat janë shitur vazhdimisht me humbje/fitim anormal për të cilën nuk mund të jepet një shpjegim ekonomik
- Klienti ndodhet në pamundësi për të justifikuar një transaksion (anomali në profil: moshë shumë e re ose shumë e vjetër)
- Klienti përdor një person të tretë për të kryer një transaksion
- Shitja/blerja e një pasurie të patundshme me një çmim shumë më të lartë ose shumë më të ulët nga vlera e tregut
- Investime në pasuri të paluajshme nga të huaj pa asnjë lidhje të dukshme me Shqipërinë ose/dhe larg profilit socialo-ekonomik të klientit
- Të ardhura nga aktiviteti profesional i klientit të cilat janë në raport të zhdrejtë me aktivitetin e biznesit
- Numri i punonjësve të shoqërisë nuk përputhet me aktivitetin e saj ose nuk justifikohet nga pikëpamja ekonomike
- Klienti kryen pagesa të shpeshta me para fizike e në shuma të konsiderueshme për blerjen e pasurive të paluajshme
- Transaksione që përfshijnë mallra me përdorim të dyfishtë veçanërisht nga vende me rrezik
- Palët në transaksion janë nga vende të njohura për mbështetje të aktivitetit dhe organizatave terroriste
- Adresa e klientit ose e personave të lidhur në marrëdhënie biznesi me të është e njëjtë me atë të personave ose subjekteve të përfshirë në listën e sanksioneve ndërkombëtare

- Mospërputhje në informacionin e marrëdhënies së biznesit ose transaksioneve (emrat e kompanive, adresat, pronari përfitues, destinacioni fundor)
- Klienti refuzon për të vendosur në dispozicion informacion i cili lidhet me burimin e fondeve dhe qëllimin e përdorimit të tyre